



**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“ACIA - CAMERA DI COMMERCIO ITALO ALBANESE” sh.p.k.**

Në Tiranë, sot më datë 25/02/2019:

**Z. Giuseppe Zito**, shtetas Italian, lindur ne Treviso( Itali) më 03/12/1982 dhe banues në adresën Via Cadore, 3/c Trevignano, identifikuar nga Karta e Identitetit Nr. CA48030BG,

**Z. Tommaso Scattolari**, lindur me dt . 25/05/1980, ne Cattolica (Itali), dhe banues ne adresen Via Sicilia 8, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit Nr. AV5894315,

Në cilësinë e “ortakeve themelues“ kane rene dakort per hartimin e ketij akt themelimi , nëpëmjet të cilit deklarojne se me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit“, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, “**ACIA - Camera di Commercio Italo Albanese**” sh.p.k

**KREUI**

Neni 1  
Krijimi

Shoqëria “**ACIA - Camera di Commercio Italo Albanese**” sh.p.k, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi te Kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “**ACIA - Camera di Commercio Italo Albanese**” sh.p.k., është një shoqëri tregtare me përgjegjesi te kufizuar.

Neni 3  
Selia

Shoqëria e ka selinë në Tirane Bulevardi “Deshmoret e Kombit”, Twin Towers kati i dyte. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, edhe nepermjet vendimit vetem nga Administratoret si edhe të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Zhvillimi i marrëdhënieve ekonomike, tregtare, shoqërore dhe kulturore midis Italisë dhe Shqipërisë dhe qytetarëve të kombësisë italiane dhe shqiptare.

Të krijojë dhe të lehtësojë kontratat për bashkëpunim Itali-Shqipëri, duke siguruar informacion për çdo person fizik ose juridik, duke përdorur mjete të ndryshme për të shpërndarë informacion mbi ekonominë, tregun, taksat, legjislacionin dhe kulturën e të dy vendeve. Shërbimet e konsulencës në fusha të ndryshme, Fitim direkt ose indirekt të interesave në kompani të tjera që kanë një objekt të ngjashëm me atë të shoqërisë në Shqipëri ose jashtë saj. Shoqëria gjithashtu mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të ligjshme që e gjykon të nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të saj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**KREU II**

**KAPITALI**

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Lekë. Kapitali i shoqërisë ndahet në 2 kuota me vlerat, si me poshte:

**Z. Giuseppe Zito**, zoterues i 1 (nje) kuote te kapitalit të shoqërisë me vlere 50 000 ( pesedhjetë mije) lek ,

;

**Z. Tommaso Scattolari**, zoterues i 1 (nje) kuote te kapitalit të shoqërisë me vlere 50000(pesedhjetë mije) lek,

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë te tregëtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta)


Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:



- 
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombetare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## *KREU II*

### *ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE*

#### *Neni 8*

#### *Organi Vendimmarrës*

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm ne rast se shoqëria është e themeluar nga nje ortak i vetem. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

*Asambleja e Pergjithshme vendos për çështje si:*

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve përpersonat e përmendur nës hkronjat "c" dhe "ç" të kësajpike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetor edhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- m) te bleje, shese, kembeje pasuri te patundshme te shoqerise;
- n) per shperndarjen e fitimit.





Vendimet e pa regjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveçrastit kur shoqëri aprovon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta.

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

#### Neni 9

##### Administrimi

Administrator i shoqërisë është Tommaso Scattolari emëruar në këtë detyrë për një afat kohor prej 5 (pesë) vite.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### Neni 10

##### Kompetencat

*Administratori ka të drejtë e detyrohet të:*

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Te hapë llogari bankare dhe te operojë për llogari të kompanisë pa limit.
- f) te kerkojë financime pa limit për kompaninë nga banka apo institucione të tjera financiare;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e





juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### Neni 11

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

#### Neni 12

##### Shpërndarja ose prishja e shoqërisë

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

#### Neni 13

##### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 14

##### Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaket themelues të shoqërisë


tregtare **“Dhoma Kombetare e tregtise, e punes dhe industrise Shqiptare” sh.p.k**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale.

**ORTAKET E SHOQERISE**

Giuseppe Zito



Tommaso Scattolari





**VERTETIM**

Sot më datë 25.02.2019, para meje noteres Ardjana A.Mediu, me seli në adresën: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 7, Tiranë, u paraqit personalisht:

**Z.Tommaso Scattolari**, shtetas Italiani, datëlindjes 25.05.1980, lindur dhe banues në Cattolica (RN), iTALI, madhor me zotësi të plotë juridikë për të vepruar, i identifikuar prej meje me Pasaportë Italiane Nr.YA3123725, në cilësinë e themeluesit të Shoqërisë "ACIA - CAMERA DI COMMERCIO ITALO ALBANESE" Sh.p.k.

**Z.Giuseppe Zito**, shtetas italian datelindjes 03.12.1982, lindur ne Treviso, Itali dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar prej meje me Karte Identiteti Italiane CA48030BG, në cilësinë e themeluesit të Shoqërisë "ACIA - CAMERA DI COMMERCIO ITALO ALBANESE" Sh.p.k.

Të cilët në prezencë të përkthyeses së gjuhës italiane **Znj. Joana Kovaçi**, e datëlindjes 07.12.1989, lindur dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Letërnjoftimit Nr. 031013904 dhe Nr. Personal I96207039C, më deklaruan se:

Dokumentin bashkëngjitur këtij akti, **Akt-Themelimi i Shoqërisë "ACIA - CAMERA DI COMMERCIO ITALO ALBANESE" Sh.p.k, date 25.02.2019**, e kanë hartuar dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë jashtë kësaj zyrë noteriale dhe e nënshkruan atë në prezencën time. Unë noterja pasi e gjej konform ligjit e vërtetoj ate rregullisht.

Përkthyes:  
*Joana Kovaçi*  
*[Signature]*

*[Signature]*  
**NOTERE**  
Ardjana A.Mediu *24*

